



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

## 5. SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE

### 1. TË PËRGJITHSHME

Shoqeria "S&T ALBANIA" Shpk eshte regjistruar si shoqeri me perjegjesi te kufizuar prane rregjistrave te Qendres Kombetare te Regjistrimeve me date 11/01/2005. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjt Nr.7638 date 19 Nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe statuti i saj.

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 38.700.000,00 leke i zotuar 100% nga ortaku i vetem i shoqerise shoqeria S&T AG , 100 kuota me vlera 387,000 leke seicila.

Administrator i shoqerise është Z.KleanthiPrifti.

Selia e shoqerise ndodhet ne rrugen "Ibrahim Rugova" Njesia nr.5 Nd 70 Hyrja Apt No.1, Tirane. Ajo eshte e regjistruar ne Degen e Tatimeve, Tirane me NIPT K52207006Q.

Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte "Tregetia dhe sherbime ne fushen e teknologjise se informacionit".

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 15 punonjës (2019: 16 punonjës).

### 2. BAZAT E PËRGATITJES

#### 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Kontabilitetit (SNK). Shoqëria ka vendosur të kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

#### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 2.4 Vlerësimet dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësimet.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njoitura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njoitura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet perkatese të pasqyrave financiare.

### 3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave te huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>Kurset e këmbimit</b>		
Euro/Lek	123.70	121.77
Usd/Lek	100.84	108.64

#### 3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përvèç së pérshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njoftes fillostarte instrumentat financiarë jo-derivativë maten së pérshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

#### Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### *Kapitali aksional*

Kapitali aksional njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

### **3.3 Aktive afatgjata materiale**

#### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-nërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale nijhet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale nijhen si shpenzim kur ato ndodhin.

### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përaindia
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete Transporti	20%
Te tjera	20%
Ndertesa	5%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

### 3.4 Aktivet financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivit.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi nijhen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja nijhet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.5 Provigionet

Një provigjon nijhet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut përvlerën në kohë të parasë dhe përrisqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

## 4. MJETE MONETARE

Teprica e likujditeteve per vitin qe mbyllte me 31 Dhjetor 2020 dhe ate qe mbyllte me 31 Dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u><b>31 Dhjetor 2020</b></u>	<u><b>31 Dhjetor 2019</b></u>
Mjete monetare ne banke	54,885,833	58,377,150
Mjete monetare ne arke	224,227	166,434
Mjete monetare transit	762,555	1,394,089
<b>TOTALI</b>	<b>55,872,615</b>	<b>59,937,673</b>

## 5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes se Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë :

	<u><b>31 Dhjetor 2020</b></u>	<u><b>31 Dhjetor 2019</b></u>
Kliente	188,365,056	167,121,773
Zhvlersimi I Llogarive te arketueshme	-11,273,854	-15,629,277
	<b>177,091,202</b>	<b>151,492,496</b>



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

## 6. Llogari te tjera te arketueshme

Ne kete ze jane paraqitur te drejta afatshkurtra te detajuara si me poshte

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Debitore dhe kreditore te tjere	-169,768	-169,768
Zhvlersim I te drejtave dhe detyrimeve per paradeniet	-1,404,072	-1,404,072
Te tjera te arketueshme	-120,074	-161,966
Paradeniet e punonjesve	1,997,667	1,997,667
Shpenzime te periudhave te ardhme	4,750	816
Llogari ne Pritje	4,085	4,085
	<u>312,588</u>	<u>266,762</u>

## 7. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

Ne kete ze jane paraqitur shpenzime per sigurime dhe jo vetem te cilat i perkasin periudhave te ardheshme.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Parapagine te dhena	2,151,729	4,820,771
Tatime te shtyra	4,310,407	6,145,594
	<u>6,462,136</u>	<u>10,966,365</u>



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

## 8. AKTIVE AFATGJATA

	Miete	Mobilie/Instalime teknike/Makineri e pallsie	Pajisje Informatike	Aktive Afata JO Materiale	Ndertesa sipas IFRS	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	12,821,104	2,420,075	8,714,126	2,949,444	10,424,252	37,329,001
Shtesa	7,020,082	414,698	662,646		18,212,840	24,310,266
Pakesime	(6,934,980)				(9,443,388)	(16,378,368)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>12,906,206</b>	<b>2,834,773</b>	<b>9,376,772</b>	<b>2,949,444</b>	<b>17,193,704</b>	<b>45,260,899</b>
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	(7,601,072)	(1,491,065)	(4,804,372)	(2,595,271)	(2,606,061)	(19,097,841)
Shtesa	(1,334,096)	(239,684)	(1,032,876)	(223,107)	(3,305,029)	(6,134,792)
Pakesime	6,004,201				2,937,049	8,941,250
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>(2,930,967)</b>	<b>(1,730,749)</b>	<b>(5,837,248)</b>	<b>(2,818,378)</b>	<b>(2,974,041)</b>	<b>(16,291,383)</b>
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	5,220,032	929,010	3,909,754	364,173	7,818,191	18,231,160
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>9,975,239</b>	<b>1,104,024</b>	<b>3,539,524</b>	<b>131,066</b>	<b>14,219,663</b>	<b>28,969,516</b>

## 9. Inventari

A	Vlera e Inventarit ne mbyllje te vitit ushtrimor 2019	30,693,858
B	Vlera e Inventarit ne mbyllje te vitit ushtrimor 2020	62,221,837
<b>c = (b-a)</b>	<b>Diferenca midis vitit 2019 dhe 2020</b>	<b>31,527,979</b>

- Jane inventari i shtuar gjate vitit 2020 dhe qe do te shitet per gjate 2021.

## 10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve per faturat e pranuara dhe ato te pamberritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Detyrime ndaj Furnitoreve per Fatura te pranuara	178,559,891	122,070,746
	<b>178,559,891</b>	<b>122,070,746</b>



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

### 11. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

Detyrimet te tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Detyrime ndaj Punonjesve	11,042,733	9,156,911
Detyrime per sigurime shoqerore & shendetesore	501,326	474,858
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	929,709	800,669
Detyrime per Tatim Fitimin	-1,294,677	1,585,251
Tatimi ne burim		-89,790
Tatime te shtyra		
Tatime te tjera per tu paguar	-215,589	-401,393
Dogana	-258,824	
TVSH per t'u paguar	4,304,367	3,313,693
	<u>15,009,045</u>	<u>14,840,199</u>

### 12. Detyrime te tjera Afatshkurtra

Detyrimet te tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Hua afatshkurtra	18,228,174	30,628,986
Parapagimet e arketueshme	4,064,704	14,402,478
Provizione afatshkurtra	5,898,760	9,151,163
	<u>26,572,646</u>	<u>54,182,627</u>

### 13. DETYRIME TE TJERA AFATGJATA

Ne kete ze eshte paraqitur detyrimi qe ka shoqeria ndaj Raiffeisen Leasing per qirane financiare per automjete. Me poshte eshte paraqitur ky detyrim per vitin qe mbylli me 31 Dhjetor 2020 dhe ate qe mbylli me 31 Dhjetor 2019 :

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Leasing - Qera financiare	13,233,536	6,200,538
	<u>13,233,536</u>	<u>6,200,538</u>



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

#### 14. KAPITALI AKSIONAR

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 38,700,000 Leke.

##### Rezerva ligjore

Nuk ka.

##### Rezerva të tjera

Rezerva ligjore nuk ka pësuar ndryshim nga viti i mëparshëm dhe është në vlerën 286 Leke

##### Divident

Ne vitin 2020 eshte shperndare 12,500,000 leke dividente per te cilin eshte paguar dhe tatimi perkates me deklaraten e muajit Prill 2020.

##### Fitimi i ushtrimit

Shuma prej **25,581,519** leke perfaqeson fitimin e vitit te mbyllur më 31 Dhjetor 2020.

#### 15. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Te ardhura nga shitja e mallrave	443,363,034	383,306,026
Te ardhura nga shitja e sherbimeve	191,639,989	211,562,060
	<b>635,003,023</b>	<b>594,868,086</b>

#### 16. TË ARDHURA TE TJERA

Të ardhura te tjera nga veprimtaria për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Te ardhura te tjera	200,042	701,382
	<b>200,042</b>	<b>701,382</b>



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

- Ne lidhje me "mosrakordin e shifres se afarizmit te pasqyruar ne bilanc me ate te deklaruara ne sistemin Informatik" si dhe differencave te te ardhurave te deklaruar ne bilanc me te ardhurat ne sistemin informatik diferenca vijne si rezultat i:

<b>Te ardhura te deklaruara ne sistem</b>	<b>635,197,707</b>
Te ardhura te njohura si rezultat i SNK	5,357
<b>Te ardhura te njohura ne Bilanc</b>	<b>635,203,064</b>

Shifra e afarizmit sipas FDP	633,408,112
Efekti i parapagimeve te marra/dhena gjate vitit	10,247,938
Efekti i shitjes se Autoveturave	-930,779
Te ardhura te shtyra dhe te ardhura te njohura gjate vitit ushtrimor sipas SNK	5,357
Te ardhura te tjera financiare	131,851
<b>Autofaturat</b>	<b>-7,659,394</b>
<b>Rrumbullakime sistemi</b>	<b>-21</b>
<b>Te ardhura te deklaruara ne sistem</b>	<b>635,203,064</b>

#### 17. LENDET E PARA DHE SHERBIMET

Sherbimet per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2019 paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Kosto e mallrave te shitura	380,212,723	337,962,575
Kosto e sherbimeve te ofruara	<u>151,445,015</u>	<u>149,055,714</u>
	<b>531,657,738</b>	<b>487,018,289</b>



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

#### **18. SHPENZIMET E PERSONELIT**

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<b><u>31 Dhjetor 2020</u></b>	<b><u>31 Dhjetor 2019</u></b>
Shpenzime per paga	44,279,543	39,892,381
Shpenzime per sigurime shoq e shend	3,512,061	3,286,219
	<b><u>-47,791,604</u></b>	<b><u>43,178,600</u></b>

- Ne lidhje me "mosrakordini e fondit te pagave te pasqyruara ne Bilanc me ate te deklaruar ne sistemin informatik" diferencat vijne si rezultat i:

	<b><u>Shpenzime per pagat te deklaruara ne sistem</u></b>	<b><u>42,664,898</u></b>
Plus	Provizione te bera per pagat vjetore te pakonsumuar	-271,177
Plus	Provizione te bera per shperblimet	1,885,822
Plus	Rumbullakime sistemi	
	<b><u>Shpenzime per pagat e punonjesve te deklaruara ne Bilanc</u></b>	<b><u>44,279,543</u></b>

Ne lidhje me "mosrakordini e sigurimeve shoqerore te pasqyruara ne Bilanc me ate te deklaruar ne sistemin informatik" diferencat vijne si rezultat i:

	<b><u>Shpenzime per sigurimet shoqerore te deklaruara ne sistem</u></b>	<b><u>3,500,456</u></b>
Plus	Provizione te bera per sigurimet shoqerore dhe shendetesore per lejen vjetore te pakonsumuar	11,605
Plus	RRumbullakime Sistemi	
	<b><u>Shpenzime per sigurimet shoqerore dhe shendetesore te deklaruara ne Bilanc</u></b>	<b><u>3,512,061</u></b>

#### **19. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI**

Shpenzimet e amortizimit per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë si me poshtë:

	<b><u>31 Dhjetor 2020</u></b>	<b><u>31 Dhjetor 2019</u></b>
Shpenzime amortizimi	<u>6,134,792</u>	<u>4,995,451</u>
	<b><u>6,134,792</u></b>	<b><u>4,995,451</u></b>



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

## 20. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2019 jane te analizuara si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Qira Zyra + magazina		
Trajtime te doc tenderash , perkthime noterizime	493,364	638,185
Mirembajtje dhe riparime	2,833,009	464,359
Marketing	824,538	269,241
Shpenzime Pritje/Percjellje	515,212	849,932
Sherbime konsulence	8,796,236	7,752,995
Shërbime telefonike+internet+postare	872,547	951,988
Komisione bankare	1,363,767	1,064,420
Taksa vendore	405,856	560,179
Blerje kancelari dhe te tjera	947,145	829,926
Shpenzime Transporti	682,374	771,630
Siguracione	666,416	166,814
Shpenzime per automjetet	815,221	1,001,891
Shpenzime udhetimi e dieta	508,877	1,977,633
Trajnime	1,762,610	1,842,208
Humbje neto nga shitje e automjetit		
Konsulenca Legale, fiskale,ISO	1,095,608	873,870
Të tjera	<u>-7,348,098</u>	<u>11,197,645</u>
	<b>15,234,682</b>	<b>31,212,916</b>

## 21. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare janë analizuara si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Shpenzime per interesa	1,541,474	576,180
Te ardhura nga interesat	273	-76
Humbje nga kembimet valutote	-19,819,687	9,982,881
Te ardhura nga kembimet valutore	20,749,876	-8,678,194
Tatim fitimi i shtyre	1,835,187	
<b>SHPENZIM</b>	<b>4,307,123</b>	<b>1,880,791</b>



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

- Ne lidhje me "mosrakordin e shpenzimeve te pasqyruara ne bilanc me ato te deklaruara ne sistemin informatik" differencat vijne si rezultat i:

<b>Totali Blerjeve sipas FDP</b>	<b>608,754,119</b>
Aktivet	3,471,750
Leasing	350,205
Shpenzime te periudhave te ardhme	95,911
Blerje Furnitura dhe nentrajtime	21,581,670
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	73,790
Efekti i deklartave doganore	12,607,165
Blerje Mallrash	562,914,233
Auto faturat	7,659,394
 <b>Diferenca</b>	 <b>0</b>
 <b>Totali shpenzimeve Bilanc</b>	 <b>(609,621,545)</b>
Tatimi mbi fitimin	(4,495,791)
Amortizimi	(6,134,792)
PAGAT-Sigurimet	(47,791,604)
Blerje financiare Neto nga FATURAT	(73,790)
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto efekt BANKAT	(2,111,830)
Blerje Furnitura dhe nentrajtime nga faturat	(21,581,670)
Blerje Furnitura dhe nentrajtime efekt bankat dhe sistemime	4,225,631
Blerje Mallrash nga faturat	(562,914,233)
Blerje Mallrash sitemime SNK	(337,256)
Ndryshim gjendje	31,593,935.80
Rrumbullakime	(145.40)
	<b>(609,621,544.65)</b>



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

<b>Shpenzimet sipas FDP-se per tatum fitimin 2020</b>	<b>612,852,679</b>
Provizione per zhvleresimin e llogarive te arketueshme	-4,355,423
Provizione per pagat per pushimet e punonjesve te pakonsumuara deri ne dt.31.12.2018	-271,177
Provizione per sigurimet Shoqerore per pagat per pushimet e punonjesve te pakonsumuara deri ne dt.31.12.2018	11,605
Provizione per zhvleresim inventari	65,956
Provizione per garanci	-2,992,837
Provizione per bunuset per arritje te objektivave te 2018 dt 31.12.2018	1,885,822
Provizione per tatum e shtyre	1,835,187
Provizione per furnioret	417,760
Provizione per sitemimmet sips IFRS 16	171,975
Rrumbullakime Sistemi	-2
<b>Shpenzime te njoitura ne Bilanc</b>	<b>609,621,545</b>

## 22. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatumore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatumore. Legjislacioni tatumor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatumore.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
<b>Fitimi Para Tatimit sipas IFRS</b>	<b>30,077,310</b>	<b>27,283,415</b>
Ndryshime Te ardhura / Shpenzime sipas IFRS	3,236,489	(13,906,195)
Rezultati ushtrimor Fiskal	26,840,636	41,189,610
<b>Shpenzimet te pazbritshme</b>	<b>3,131,304</b>	<b>3,457,381</b>
Subscription Fee	63,580	180,083
Subbscription FEE PANJOHURA	116,748	1,190,771
TRAININGS	78,004	300
Trainings e panjohur	1,179,221	24,288



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

INSTALIME TE NDRYSHME	30,478	29,051
Mirembajtje dhe riparime zyre (FAT.E NJOHUR)	2,914	1,320
Mirembajtje dhe riparime zyre (FAT.E PANJOHUR)	193,649	33,100
Mirembajtje dhe riparime makine (Fat.e NJOHUR)	450	119,475
Mirembajtje dhe riparime makine (Fat.e PANJOHUR)	43,060	22,300
Te tjera	207,365	17,659
Te tjera te PANJOHURA	111,628	16,139
Shpenzime parkimi (Te panjohura)	38,050	26,460
Blerje dokumenta tenderi (te panjohura)	5,000	103,781
VERTETIME PER TENDERA (PANJOHUR)	2,100	1,255
Kancelari( fat e panjohur)	15,528	48,700
Marketing (fature e panjohur)	11,096.16	33,000
SHPENZIME PERKTHIMI DHE NOTERIZIMI (TE PANJOHURA)	1,680.00	25,540
Transferim, Udhetim,Dieta (te panjohur)	6,951.81	300
HOTEL (TE PANJOHURA)	42,060.38	1,960
BILETE AVIONI/TRAGETI/TRENI ETJ (TE PANJOHURA)	69,355.78	557,314
SHPENZIME POSTARE (Te panjohura)	1,710.00	152,663
Transport per Blerje (fature e panjohur)	134,100.00	9,600
Transporte per Shitje (fature e panjohur)	4,000.00	862,320
Karburant per makinat (fat. e panjohur)	48,174.12	3
Transport per personelin (fat.panjohur)	9,690.00	
Sherbime bankare	200.00	
Sh. pritje dhe percjellje (F. e panjohur)	314,094.49	
Gjoba dhe demshperblime	125,842.75	



S&T Albania Sh.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

SKY TOWER, 11<sup>th</sup> Floor, No.1,  
Tirana Albania

Shpenzime panjohura L.	274,388.16	
<b>Fitimi Fiskal</b>	<u>29,971,940</u>	<u>44,646,991</u>
<b>Tatimi Mbi Fitimin vjetor(15%)</b>	<u>4,495,791</u>	<u>6,697,049</u>
<b>Tatimi Mbi Fitimin e shtyre</b>		
<b>Fitimi Humbja Neto Tregetare</b>	<u>25,581,519</u>	<u>20,586,366</u>
<b>Fitimi Humbja Neto Fiskale</b>	<u>25,476,149</u>	<u>37,949,942</u>

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Tatim Fitimi i Parapaguar 2020/2019	5,790,468	4,587,352
Tatim Fitimi 2020/2019	<u>4,495,791</u>	<u>6,697,049</u>
<b>Tatim Fitimi per tu paguar/gjendje</b>	<u>1,294,677</u>	<u>1,585,251</u>

### 23. Palet e lidhura

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë detajuara si më poshtë:

#### Te pagueshme ndaj paleve te lidhura

#### 31 Dhjetor 2020 neLek

S&T AG	19,736,395
S&T MAcedonia	<u>18,301,910</u>
	<u>38,038,805</u>

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të tregut.

## 24. ANGAZHIME DHE PASIGURI

### Çështje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

### Detyrimet tatimore

Librat e Shoqerise nuk janë audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020. Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund te konsiderohen perfundimtare. Detyrime te mundshme qe mund te rezultojne nga një auditim i organeve tatimore nuk mund te maten ne menyre te besueshme.

## 25. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

## 26. LISTIMI NE BURSE


Bazuar ne Nenin 4, Ligji Nr.9228 "Ligji per Kontabilitetin", per shoqerite e listuara ne një burse zyrtare lettrash me vlore dhe filialat e tyre, subjekt i konsolidimit te llogarive duhet te zbatohen detyrimisht Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit. Duke qene se kompania S&T Albania gjate vitit 2020 eshte objekt konsolidimi i pasqyrave Financiare me Kompanine meme S&T AG te listuar ne bursen e Frankfurtit, eshte e detyrueshme mbajtja e kontabilitetit sipas SNK Per reference me poshte linku i burses se Frankfurtit ku eshte listuar grupi S&T AG:

<http://www.boerse-frankfurt.de/en/equities/s+t+ag+ag+AT0000A0E9W5>

## HARTOI PASQYRAT FINANCIARE

FINANCIERE

**ELVINA BANAJ (HYSI)**



## MIRATOI PASQYRAT FINANCIARE

ADMINISTRATORI

**KLEANTHI PRIFTI**



**FORMULAR I DEKLARIMIT DHE  
PAGESES SE TATIMIT MBI FITIMIN**



(2) Periudha tatimore

20-A

(1) Numri Serial:

**Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)**  
(Vetem per perdonim zyrtar)

**Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):**

(3) K52207006Q

**Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:**

(4) S & T ALBANIA

**Emri Mbiemri i Personit Fizik:**

(5)

**Adresa:**

(6) Njesia Administrative Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova,  
Nd.70, Hyrja 5, Apartamenti Nr.1, 1019

**Qyteti/Komuna/Rrethi:**

Tirana, Tirane, Tirane

**Numri Telefonit:**

(7)

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plete ose ka ndryshuar

**Llogarija e rezultatit**

**Te ardhurat dhe shpenzimet**

**Të ushtrimit**

**Tatimore**

- |         |                          |      |             |      |             |
|---------|--------------------------|------|-------------|------|-------------|
| (8/9)   | Te ardhurat              | (8)  | 635,203,065 | (9)  | 635,197,709 |
| (10/11) | Shpenzimet               | (10) | 605,125,939 | (11) | 608,356,885 |
| (12)    | Shpenzimet e pazbritshme |      |             | (12) | 3,131,119   |

**Rezultati**

- |         |                                 |      |            |      |            |
|---------|---------------------------------|------|------------|------|------------|
| (13/14) | Humbja                          | (13) | 0          | (14) | 0          |
| (15/16) | Fitimi                          | (15) | 30,077,126 | (16) | 29,971,943 |
| (17)    | Humbje e mbartur                |      |            | (17) | 0          |
| (18)    | Fitimi i tatueshem neto (16-17) |      |            | (18) | 29,971,943 |

**Llogarija e tatum fitimit**

- |      |                                             |      |           |
|------|---------------------------------------------|------|-----------|
| (19) | Tatum fitimi me shkallen tatumore standarte | (19) | 4,495,791 |
| (20) | Tatum fitimi me perqindje te tjera          | (20) | 0         |
| (21) | Tatum fitimi me perqindje te tjera          | (21) | 0         |
| (22) | Tatum fitimi (19+20+21)                     | (22) | 4,495,791 |
| (23) | Tatum fitimi i shtyre                       | (23) | 0         |
| (24) | Tatum Fitimi i detyrueshëm për t'u paguar   | (24) | 4,495,791 |